



RCDN Regional Capacity
Development Network
for Water and
Sanitation Services



TRAJNIMET

TRAJNIM PËR “PROJEKTET E INVESTIMEVE TË INFRASTRUKTURËS SË KAPITALIT PËR SHËRBIMET E UJIT DHE KANALIZIMEVE”



ÇFARË DO TË MËSONI?

Temat kryesore të trajnimit:

- Qasja në Financim për Projektet e Investimeve të Infrastrukturës së Kapitalit në Sektorin e Ujit dhe Kanalizimeve dhe Përgatitja e Suksesshme e Projektit nga Perspektiva e Vendimmarrësve
- Elementët kyç të fazave të Ciklit të Menaxhimit të Projektit për Kryetarët e Bashkive dhe Menaxherët e Shoqërive Ujës-jellës Kanalizime
- Marrëveshjet Ligjore dhe Institucionale për zbatimin e Investimeve Komplekse të Infrastrukturës



KUSH DO TE TAKOHET?

Grupi i synuar:

Vendimarrësit e Bashkive dhe Shoqërive të Ujës-jellës Kanalizimeve: (1) Këshilltarët Bashkiak, dhe (2) Kryetarët e Bashkive; (3) Menaxherët e Përgjithshëm; (4) Anëtarët e bordeve mbikëqyrëse të Shoqërive të Ujës-jellës Kanalizimeve; (5) Menaxherët teknikë dhe (6) Menaxherët e financave.



METODOLOGJIA E TRAJNIMIT:

Trajnimi është interaktiv dhe përfshin: (1) prezantime, (2) të mësuarit nëpërmjet punës në grupe, (3) analiza të studimit të rasteve (4) shembuj të praktikave më të mira.



KOHËZGJATJA E TRAJNIMIT: Një ditë



Cilat janë përfitimet për ju?

- Pjesëmarrësit njihen me rolet dhe përgjegjësitë e tyre për përgatitjen e projekteve financuese dhe qasjen në fonde.
- Pjesëmarrësit janë në gjendje të kuptojnë elementët kryesorë dhe fazat e menaxhimit të ciklit të projektit dhe të sigurojnë mbështetje adekuatë në secilën fazë.
- Pjesëmarrësit janë në gjendje të përmbushin kërkesat ligjore të donatorëve dhe Institucioneve Financiare Ndërkombëtare dhe të sigurojnë kornizën e nevojshme institucionale për zbatimin e projektit të investimeve në infrastrukturë.

At the source of knowledge.



Çfarë ofrojmë?

RCDN ofron:

- Produktet me cilësi të lartë të Zhvillimit të Kapaciteteve që u përgjigjen nevojave dhe kërkesave të palëve kryesore të interesit në sektorin e ujit dhe ujërave të ndotura në Evropën Juglindore,
- Trajnues të shkëlqyeshëm kombëtar dhe rajonal dhe ekspertë me aftësi të përgjithshme dhe specifike si edhe me përvojë në sektor,
- Modulet e trajnimit të zhvilluara në një vlersim paraprak dhe analizë të hollësishme,
- Shkëmbime mes kolegëve që u mundësojnë të mësuarit nga njëri - tjetri në kontekste të ndryshme,
- Materialet e trajnimit të përpunuara mirë dhe seancat interaktive.




Kush jemi ne?

RCDN synon të rrisë efektivitetin dhe efikasitetin e shoqërive të ujit në Evropën Juglindore, duke kontribuar në ofrimin e shërbimeve më të mira me numrin më të madh të grupeve të popullsisë që kanë qasje në shërbimet e ujit të pijshëm dhe kanalizimeve dhe në përmbushjen e Acquis Communautaire të Bashkimit Eurpian.

Për të arritur këtë, RCDN fokusohet kryesisht në tre fusha kyçe: 1) Zhvillimi i Shoqatës, 2) Oferta për Zhvillimin e Kapaciteteve dhe Shpërndarja e saj, dhe 3) Partneriteti dhe Mundësimi i Mjedisit për Zhvillimin e Kapaciteteve.

RCDN është partner i 16 shoqatave kombëtare (Shoqatat e Bashkive dhe Shoqatat e Shoqërive Ujësjetllës Kanalizimeve) në 6 vende të rajonit (Shqipëri, Bosnje Hercegovinë, Kosovë, Maqedonia e Veriut, Mal i Zi dhe Serbi). Përfituesit final janë menaxherët kryesorë dhe të mesëm nga bashkitë dhe kompanitë e shoqërive ujësjetllës kanalizimeve në rajon dhe zyrtarët përgjegjës në bashki.

Projekti i cili mbështet rrjetin menaxhohet nga GIZ, në emër të SECO në Zvicër dhe BMZ në Gjermani dhe zbatohet nga një Ekip i Implementimit të Projektit që përbëhet nga tre rrjete rajonale IAWD, Rjeti AQUASAN në Bosnje Hercegovinë dhe NALAS.



Trajnimi i parë për projektet e Investimeve të Infrastrukturës Kapitale në sektorin e ujit dhe kanalizimeve që u zhvillua në shkurt 2019 në Tiranë siguroi një pjesëmarrje të gjerë nga Bashkitë dhe nga Shoqëritë Ujësjetllës Kanalizime, të cilët ende nuk kanë kapacitete të mjaftueshme për të zbatuar projekte, duke përfshirë këtu edhe kapacitetet financiare, bashkëfinancim të siguruar për projekte, kapacitetet institucionale dhe menaxhuese, kapacitete teknike dhe operacionale. Prandaj, ata janë të gatshëm të trajnohen dhe të marrin maksimumin prej tyre, të ndajnë ekspertizën dhe sfidat, por ende i mungojnë kapacitetet, gjë që është çështja e tyre kryesore e ngritur.

Trajnimi tregoi se pjesëmarrësit ishin duke reflektuar në pyetjet e ngritura, në seancën plenare dhe ishin në gjendje të kontribuonin në mënyrë profesionale në diskutim. Meqë ata përfaqësonin sektorë të ndryshëm, një ndihmesë e madhe ishte dhe të mësuarit nga kolegët. I gjithë grupi tregoi interes për temat e mbuluara dhe studimet e rasteve të diskutuara, dhe shpërndanë njohuritë e përbashkëta personale dhe përvojën në projektet e ujit dhe kanalizimeve.

Si të aplikoni?

Nëse dëshironi të jeni pjesë e kësaj përvoje, ju lutemi na kontaktoni me e-mail ose telefon:

FOCAL POINT: Xhesi Demishago, info@aam.org.al; 04 246 8492
Më shumë informacione, mund të gjendet: www.rcdnsee.net

Trajnere dhe Nëndrejtoreshë e Përgjithshme e Ujësjetllës Kanalizimeve Tiranë



www.rcdnsee.net

Follow us:

